



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 333/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.05.2018 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

**Objekt:**

Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Josif Deliu” sh.p.k. nga procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-41452-01-22-2018, me objekt: “*Blerje Karburant*”, Loti 1 “*Naftë*”, me fond limit 30.135.061 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.

**Ankimues:**

“Olsi” sh.p.k.  
Rruga Fier – Patos, Km 6, Zona Industriale Grizë, Patos

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Korçë  
Rruga “28 Nëntori”, Korçë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23.01.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-41452-01-22-2018, me objekt: “Blerje Karburant”, Loti 1 “Naftë”, me fond limit 30.135.061 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.

II.2. Në datën 15.02.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 28.02.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

- |                              |        |                         |              |
|------------------------------|--------|-------------------------|--------------|
| 1. “Gega Center GKG” sh.p.k. | 4 %    | (Marzhi i fitimit në %) | skualifikuar |
| 2. “Josif Deliu” sh.p.k.     | 4 %    | (Marzhi i fitimit në %) | skualifikuar |
| 3. “Aroil Company” sh.p.k.   | 4.75 % | (Marzhi i fitimit në %) | skualifikuar |

4. “Olsi” sh.p.k.	5.7 % (Marzhi i fitimit në %)	kualifikuar
5. “A&T” sh.p.k.	7.38 % (Marzhi i fitimit në %)	skualifikuar
6. “Kastrati” sh.p.k.	7.9 % (Marzhi i fitimit në %)	kualifikuar
7. “Eroil” sh.p.k.	9.2 % (Marzhi i fitimit në %)	skualifikuar

II.4. Në datën 15.03.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e ri-vlerësimit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

1. “Gega Center GKG” sh.p.k.	4 % (Marzhi i fitimit në %)	skualifikuar
2. “Josif Deliu” sh.p.k.	4 % (Marzhi i fitimit në %)	kualifikuar
3. “Aroil Company” sh.p.k.	4.75 % (Marzhi i fitimit në %)	skualifikuar
4. “Olsi” sh.p.k.	5.7 % (Marzhi i fitimit në %)	kualifikuar
5. “A&T” sh.p.k.	7.38 % (Marzhi i fitimit në %)	skualifikuar
6. “Kastrati” sh.p.k.	7.9 % (Marzhi i fitimit në %)	kualifikuar
7. “Eroil” sh.p.k.	9.2 % (Marzhi i fitimit në %)	skualifikuar

II.5. Në datën 20.03.2018 operatori ekonomik ankimes “Olsi” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik “Josif Deliu” sh.p.k në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht në ankesë pretendohet si më poshtë vijon: *Në lidhje me rivlerësimin e procedurës së prokurimit zhvilluar nga ana e AK Bashkia Korçë, vërejtje se është kualifikuar subjekti Josif Deliu. Ne kundërshtim me vlerësimin e KVO-se, që ka vendosur skualifikimin e këtij subjekti për arsye se: 1. Kopjet e bilancave kanë qenë të pamiratuara dhe të pakontrolluara nga organet e administratës tatimore. 2. Autobotin e ka në emrin personal pra përdorim personal dhe nuk ka asnjë dokument që të vertetojë kryerjen e transaksioneve të ligjshme sipas ligjit tatimor. 3. Mostrat e paraqitura nuk janë neperputhje me specifikimet teknike. Pra flete analizat e mallit.*

*AK me kualifikimin e këtij subjekti ka legjitimuar një shkëlqje dhe një pabarazi ndërmjet subjekteve konkurruese. AK ka lejuar që gara të jete e pabarabarte ndërmjet subjekteve duke toleruar evazionin fiskal të subjektit Josif Deliu, si dhe të pranojë produkte në cilësi të kërkuar. AK ka shkëlqur hapazi dhe në mënyrë të qëllimshme për të favorizuar këtë subjekt, parimet e nënve 1 dhe 2 të LPP-se, nën 23,45,46, 53,54,55 të LPP-se si dhe nën 27 të VKM Nr. 914, dt. 29.12.2014. AK në një kohë që forca e ligjit po qëndron si çekan ndaj shkelësve, ka kryer një shkëlqje edhe me të rëndë pasi me veprimet dhe mosveprimet e tij në vlerësimin e pare dhe në procesin e ankimit ka lehtësuar pozitën juridike të këtij subjekti duke e skualifikuar vetëm për një element atë të mosparaqitjes së bilancave, dhe nuk kanë mbajtur asnjë akt konstatimi për shkeljet e tjera pra për shkeljet 2 dhe 3 të kësaj anese. Ndaj kërkojmë që AK të rivlerësojë procedurën duke bërë një rishikim administrativ me qëllim identifikimin e shkeljeve në kriteret e vecanta për kualifikim në pikën 2.2, kapaciteti teknik, pika 3. Kërkojmë nga ana juaj të merren mostra për raportin e analizës së cilësisë të karburantit nga të gjitha pistoletat që disponon në pikën e shitjes subjekti Josif deliu, pasi karburanti që ai tregtin nuk plotëson asnjë standart teknik. Të verifikohet raporti i analizës së paraqitur pasi elementet e veprës penale të falsifikimit janë mëse evidente. Ky subjekt nuk furnizohet nga distributorët e ligjshëm dhe si i tillë nuk mundet të ofrojë një marzh fitimi kaq të ulët, ndërkohe që kostot administrative rriten me një sasi, kushte kontraktore dhe cilësi të tillë. Në kriteret e vecanta për kualifikim në pikën 2.2, kapaciteti teknik pika 4: Ky subjekt autobotin nuk e*

*ka ne emer te firmes dhe nuk pasqyrorhet ne bilancet. Autoboti eshte ne emer personal te administratorit por qe ky i fundit per arsye te shmangies se detyrimeve tatimore, doganore e ka ne emer te tij. Ai nuk ka asnje kontrate sikunder kerkohet ne DST per te dhene ne perdorim me qira mjetin tek fimra qe administron. Te gjitha keto veprimime duhet te vlerësohen nga AK si jo ne perputhje me kerkesat DST dhe oferta e tij te skualifikohet.*

II.6. Në datën 27.03.2018, nëpërmjet shkresës me nr. 1364/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar ankesën me argumentimin si më poshtë vijon:

*-Ne daten 05.03.2018 ka paraqitur ankese shoqeria Josif Deliu sh.p.k lidhur me vleresimin e bere nga KVO per Lotin I Nafte. Me Vendim date 12.03.2018 komisioni i ngritur per shqyrtimin e ankeses te paraqitur nga shoqeria "Josif Deliu" sh.p.k ne lidhje me vleresimin procedures te prokurimit me objekt "Blerje Karburanti" Loti I Nafte mori vendim qe te pranoje ankesen e paraqitur nga shoqeria "Josif Deliu" sh.p.k. Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbasi u njoh me vendimin e Komisionit te Shqyrtimit te Akesave beri rivleresimin e procedures dhe kualifikoi shoqerine "Josif Deliu" sh.p.k. Per sa me siper konstatohet se procedura e ndjekur eshte ne perputhje me nenin 78 pika 6.ç, te VKM Nr 914 date 29.12.2018 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" [...].*

*2. Lidhur me pretendimin se autoriteti kontraktor "duhet te marre mostra per raportin e analizes se cilesise te karburantit nga te gjitha pistoletat qe disponon ne piken e shitjes te subjektit Josif Deliu pasi karburanti qe ai tregon nuk ploteson asnje stadndart teknik", Zyrtari i Autorizuar per Shqyrtimin e Ankeses konstatoi se: Ne dokumentat e tenderit nuk eshte vendosur si kriter kualifikimi dorezimi apo marrja e mostrave. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhejodiskriminuese". Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "Autoriteti kontraktor, ne zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit." Pra Komisioni i Vleresimit te Ofertave dhe Komisioni i Shqynimit te Ankesave bejne vleresimin e tyre vetem bazuar ne kriteret e vendosura ne dokumentat e tenderit. Per sa me siper pretendimi i ankimuesit nuk qendron.*

*3. Lidhur me pretendimin: "Te verifikohet raporti i analizes se cilesise te paraqitur pasi elementet e vepres penale te falsifikimit jane mese evidente. Ky subjekt nuk furnizohet nga distributoret e ligjshem dhe si i tille nuk mundet te ofroje nje marzh fitimi kaq te ulet nderkohe qe kostot administrative rriten me nje sasi kushte kontraktore dhe cilesi te tille". Pretendimet e ankuesit nuk mbështeten në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime nderkohe qe është barrë e ankuesit qe të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij. Ne dokumentat e tenderit, ne specifikimet teknike eshte percaktuar shprehimisht se "Kontraktuesi sebashku me faturen e mallit qe do te paraqitet per likujdim duhet te paraqese edhe flete analizat per karburantet e kerkuar nga autoriteti kontraktor". Per sa me siper bazuar edhe ne nenin 62 te ligjit 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të*

monitorojë zbatimin e kontratës për t'u siguruar nëse cilësia e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë dhe për të vertetuar këto është kërkuar që të paraqiten dhe flete analizat sebashku me faturen e mallit. Gjithashtu, referuar nenit 1 gërma "b" "Objekti dhe qëllimi" i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se "Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedural. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar "çmimit më të ulët"), në rast se nuk evidentohen shkelje të atij karakteri që të konsiderohen haptazi në kundërshtim me ligjintë tilla që të ndikojnë në mirëpërdorimin e fondeve publike, si qëllim parësor të Ligjit nr. 9643 , date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" (të ndryshuar). Ligji i prokurimit publik nuk ka për qëllim që nëpërmjet tij dhe përcaktimeve të tij të kontrollohen një sërë ligjesh të tjera, pasi ka organe të tjera që merren me kontrollin dhe monitorimin e respektimit të legjislacionit në lidhje me karburantet, distributorët, evazionin fiskal etj. Për sa më sipër pretendimi i ankimesit nuk qëndron. Në përfundim zyrtari i autorizuar për shqyrtimin e ankesës vendosi të mos pranojë ankesën e paraqitur nga shoqëria "Olsi" sh.p.k.

II.7. Në datën 03.04.2018 operatori ekonomik ankimesit ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si në autoritetin kontraktor. Ndër të tjera ai ka argumentuar:

*Kompania jone Olsi shpk me datë 15.02.2018 ka marre pjese ne procedure e prokurimit me objekt Blerje karburanti, ne te dyja lotet. Ne lotin e pare blerje nafte ne jemi shpallur te paret si oferte e kualifikuar sipas vleresimit te dates 28.02.2018. Pas disa ditesh e dt. 12.03.2018 pas nje rivleresimi nga ana e AK, ka kualifikuar subjektin Josif Deliu shpk. ne kundërshtim me LPP duke cenuar te drejtat tona te ligjshme ne kete procedure prokurimi ku nga fitues te procedures renditemi te dytet, pra mosfitues. Ne lidhje me rivleresimin e procedures se prokurimit zhvilluar nga ana e AK Bashkia Korce, jemi ankimeuar prane AK Bashkia Korce me dt. 20.03.2018 ku verejme se eshte kualifikuar subjekti Josif Deliu, ne kundërshtim me vleresimin e KVO-se, qe ka vendosur skualifikimin e ketij subjekti per arsye se:*

- 1. kopjet e bilancave kane qene te pamiratuara dhe te pakontrolluara nga organet e administrates tatimore.*
- 2. Autobotin e ka ne emrin personal pra perdorim personal dhe nuk ka asnje dokument qe te vertetoje kryerjen e transakcioneve te ligjshme sipas ligjit tatimor.*
- 3. Mostrat e paraqitura nuk jane ne perputhje me specifikimet teknike. Pra flete analizat e mallit. AK me kualifikimin e ketij subjekti ka legjitimuar nje shkelje dhe nje pabarazi ndermjet subjekteve konkurruese. AK ka lejuar qe gara te jete e pabarabarte ndermjet subjekteve duke toleruar evazionin fiskal te subjektit Josif deliu, si dhe te pranoje produkte nen cilesine e kerkuar. AK ka shkelur haptazi dhe ne menyre te qellimshme per te favorizuar kete subjekt, parimet e neneve 1 dhe 2 te LPP-se, nenin 23, 45, 46, 53, 54, 55 te LPP-se si dhe nenin 27 te VKM Nr. 914, dt. 29.12.2014. Ne ankesen tone drejtuar AK kemi theksuar nder te tjera se "AK ne nje kohe qe forca e ligjit po qendron si cekan ndaj shkelesve, ka kryer nje shkelje edhe me te rende pasi me veprimet dhe mosveprimet e tij ne vleresimin e pare dhe ne procesin e ankimit ka lehtesuar poziten juridike te ketij subjekti duke e skualifikuar vetem per nje element ate te mosparaqitjes se bilanceve, dhe nuk kane mbajtur asnje akt konstatimi per shkeljet e tjera pra per shkeljet 2 dhe 3 te kesaj ankese.*

*Ndaj kerkojme qe AK te rivleresoje procedure duke bere nje rishikim administrative me qellim identifikimin e shkeljeve: ne kriteret e vecanta per kualifikim ne piken 2.2, kapaciteti teknik, pika 3. Kerkojme nga ana juaj te merren mostra per raportin e analizes se cilesise te karburantit nga te gjitha pistoletat qe disponon ne piken e shitjes subjekti Josif Deliu, pasi karburanti qe ai tregton nuk ploteson asnje standart teknik. Te verifikohet raporti i analizes se paraqitur pasi elementet e vepres penale te falsifikimit jane mese evidente. Ky subjekt nuk furnizohet nga distributoret e ligjshem dhe si i tille nuk mundet te ofroje nje marzh fitimi kaq te ulet, ndërkohë që kostot administrative rriten me nje sasi, kushte kontraktore dhe cilesi te tille.*

*Ne kriteret e vecanta per kualifikim ne piken 2.2. kapaciteti teknik pika 4: Ky subjekt autobotin nuk e ka ne emer te firmes dhe nuk pasqyrohet ne bilancet. Autoboti eshte ne emer personal te administratorit por qe ky i fundit per arsye te shmangies se detyrimeve tatimore, doganore e ka ne emer te tij. Ai nuk ka asnje kontratë sikunder kerkohet ne DT per te dhene ne përdorim me qira mjetin tek firma qe administron. Te gjitha keto veprime duhet te vleresohen nga AK si jo ne perputhje me kerkesat DT dhe oferta e tij te skualifikohet. AK me dt. 28.03.2018 ka kthyer përgjigjen per pretendimet tona, ne menyre aspak terësore dhe shume siperfaqesore madje ne shtrembërim dhe keqinterpretim te fakteve dhe argumentave te paraqitura nga ana jone. AK kerkesen tone per rivleresim te ofertes se subjektit Josif Deliu sepse AK ka lehtesuar poziten e subjektit Josif Deliu per shkak se kopjet e bilanceve nuk kane qene te miratuara dhe kontrolluara nga organet e administrates tatimore dhe se mostrat e paraqitura nuk jane ne perputhje me specifikimet teknike, dhe kerkeses sone shtese per te verifikuar raportin e analizës se paraqitur, e ka trajtuar ate ne menyre perjashtuese, devijuese dhe aspak shteruese e ka trajtuar kete kerkese me nje element mbeshtetes te argumentimit.*

*Ne kemi kerkuar qe: "1. Kerkojme nga ana juaj te merren mostra per raportin e analizes se cilesise te karburantit nga te gjitha pistoletat qe disponon ne piken e shitjes subjekti Josif Deliu, pasi karburanti qe ai tregton nuk ploteson asnje standart teknik. 2. Te verifikohet raporti i analizes se paraqitur pasi elementet e vepres penale te falsifikimit jane mese evidente..." AK në përgjigjen e tij ka trajtuar si pretendim qe nuk qendron kerkesen tone por duke e trajtuar pjeserisht dhe jashte kontekstit kerkese tonen. AK ngre argumentin se ne DST nuk eshte vendosur si kriter kualifikimi dorezimi apo marrja e mostrave dhe se referuar nenit 46 OE ekonomike duhet te kualifikohen pasi te kene permbushur te gjitha kriteret qe AK i vlereson te nevojshme persa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohen dhe jo diskriminuese. Dhe se KVO dhe KSHA bejne vleresimin e tyre vetem bazuar ne kriteret e vendosura ne DT. AK nuk ka trajtuar fare verifikimin e raportit te analizes dhe nuk eshte shprehur nese raporti i dorezuar i ploteson ose jo specifikimet e vete AK. Kerkesa jone ne te vertete lidhet me dy elemente, me verifikimin dokumentar dhe ate faktik. Per te paren AK nuk shprehet fare, ndonese KVO dhe KSHA kete kerkese e kane ne DT, seksioni 2.2 pik 3 e KVK dhe jo sic pretendon AK se ky kriter nuk eshte kerkuar ne DT. Per kete arsye ne mungese te shprehjes se AK kerkojme qe KPP te detyroje AK te shprehet ne lidhje me kete pjese ose te beje vete vleresimin e kerkeses sone si çështje në themel.*

*Ne lidhje me argumentimin e AK per pretendimin e dyte se pretendimet tona nuk mbeshteten ne asnje argument, por vetem mbi pretendime hipotetike e dyshime ....., ne e kemi bere te qarte se oferta et ij eshte shume e ulet, duke nenkuptuar qarte se kjo oferte eshte anomalisht e ulet. AK bazuar ne ofertat anomalisht te uleta ka detyrimin te kerkoje sqarime ne lidhje me kete oferte anomalisht te ulet. AK duke pranuar kerkesen ka shkelur nenin 53, 63, te LPP-se si dhe nenin 66, pika 5 te VKM Nr. 914, per shqyrtimin e ofertave anomalisht te uleta. Dhe nuk ka kerkuar sqarime*

ne lidhje me kete oferte anomalisht te ulet. Pra AK konstatojme se nuk ka kerkuar sqarime dhe nuk e ka vene ujin ne zjarr qe kjo oferte ishte anomalisht e ulet. Mesa shohim ofertat e kualifikuara jane: Josif Deliu 4, Olsi sh.p.k. 5.7, Kastrati sh.p.k. 7.9, Mesatare Oferta 5.86. Referuar VKM Nr. 914, “Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme “kufri i ofertes se pergjegjshme eshte 4.98. Pra del qarte se Oferta e Josif Deliuut eshte anomalisht e ulet. Kerkesa jone ishte nje orinetim ne funksion te kesaj kerkese per AK si dhe ishte parashtrimi i mjeteve te kerkimit te proves administrative per kete oferte anomalisht te ulet, ku ndonese nuk eshte e percaktuar ne DT kete tager diskrecional ja jep vete LPP per verifikimin e ofertes anomalisht te ulet AK. Teresia e kesaj mungese koherence ne veprimet dhe mosveprimet e AK deshmojne se OE Josif Deliu eshte ne kushte favorizuese te hapura nga AK ne dem te konkurences, ligjshmerise fiskale dhe trajtimit te barabarte per te drejtat dhe detyrimet qe iu ngarkohen OE. Per sa me siper ne lidhje me kete argument kerkojme nga KPP skualifikimin e subjektit Josif Deliu shp.k per shkak se eshte oferte teresisht e papergjegjshme, nuk respekton kushte teknike te cilesise.

Ne lidhje me pretendimin e AK se ne DT, “specifikimet teknike eshte percaktuar shprehimisht se “Kontraktuesi se bashku me faturen e mallit qe do te paraqitet per likujdim duhet te paraqese edhe flete analizat per karburantete kerkuara nga AK” dhe se AK eshte organi me interes dhe pergjegjesi per zbatimin e kontrates per tu siguruar nese cilesia e mallrave eshte e njejte me cilesine e premtuar ne oferte dhe te percaktuar ne kontrate dhe per te vertetuar kete eshte kerkuar qe te paraqiten fleteanalizat se bashku me faturen”, shohim se AK qelimisht ka devijuar thelbin e kerkeses. AK e ka pasur kriter ne KVK qe OE te dorezoje flete analizat shih ref. me siper pika 3 e KVK seksioni 2.2. fakti qe ne specifikimet teknike jane vendosur kushte plotesuese per zbatimin e kontrates, nuk i jep diskrecion AK te devijojenga parimet e LPP-se per procesin e konkurrimit te, barabarte. Mbeshtetja e AK ne kushtet e zbatimit te kontrates dhe jo ne KVK deshmon se AK nuk ka pasur asnje argument te ligjshem per te kundershuar pretendimet tona. AK ka pranuar nje oferte anomalisht te ulet pa kerkuar sqarime dhe per me teper nuk respekton parimin e kontradiktoritetit. Pra nga njera ane pranon se vleresimi behet vetem mbi bazen e kerkeseve te permendura ne DT dhe nga ana tjeter devijon te trajtoje ktheje pergjigje per ate cfare eshte kerkuar nga ai vete ne DT. Pra AK nuk shprehet per fleteanalizat, te kerkuara ne KVK dhe nga ana tjeter kur i kerkohet te shprehet devijon duke i leno vetes tager te vetgjykoje pergjate zbatimit te kontrates. AK i kerkohet indirekt te ushtroje diskrecionin per oferten anomalisht te ulet dhe nga ana tjeter nuk pranon ta ushtroje kete diskrecion dhe madje nuk respekton procedurat ligjore per te kerkuar sqarime per oferten anomalisht te ulet. Kjo mbi bazen e nenit 36 e vijues te ligjit 8438, dt, 28.12.1998, i ndryshuar. Transferimi i kostos nuk parashikon me kete marzh fitimi te ulet as nje fitim per tregtuesin e shumices!!!! Pra marzhi i fitimi duke iu shtuar mekanizmit te cmimit per karburantin do deshmoje se nuk eshte respektuar ne teresi legjislacioni tatimor dhe si tille duhet te trajtohet si oferte anomalisht e ulet minimalisht ose si oferte qe nuk respekton legjislacionin tatimor per transferimin e kostos se cmimit shih bazen ligjore me siper.

Ne lidhje me kerkesen tone per: Ne kriteret e vecanta per kualifikim ne piken 2.2, kapaciteti teknik pika 4: Ky subjekt autobotin nuk e ka ne emer te firmes dhe nuk pasqyrorhet ne bilancet. Autoboti eshte ne mer personal te administratorit por qe ky I fundit per arsye te shmangies se detyrimeve tatimore, doganore e ka ne emer te tij. Ai nuk ka asnje kontrate sikunder kerkohet ne DT per te dhene ne perdorim me qira mjetin tek firma qe administron: te gjitha keto veprime duhet te



*vleresohen nga AK si jo ne perputhje me kerkesat DT dhe oferta e tij te skualifikohet AK nuk ka kthyer asnje pergjigje dhe nuk e trajtuar fare kete kerkese qe eshte vete thelbi i ankeses tone. AK ka kthyer nje pergjigje gjysmake pasi nuk ka asnje kunderargument per kete pretendim tonin. Referuar edhe vendimanes se KPP-se ku vete subjekti yne ne proceduren e prokurimit ..... eshte skualifikuar per te njejtin argument (shih vendimin e KPP-se).ne kerkojme skualifikimin e subjektit Josif Deliu si te pakualifikuar per arsye se nuk ka autobot ne emer te firmes, por ne emer personal qe nuk rezulton kurkund si dhe nuk ka asnje kontrate sic kerkohet ne DT per te dhene ne perdorim me qira mjetin tek firma qe administron.*

II.8. N p rmjet shkres s me nr. 1786/1 prot., dat  10.04.2018, t  protokolluar me ton n n  dat n 13.04.2018,  sht  deponuar n  Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedur n e m sip rme t  prokurimit dhe trajtimin e ankes s s  operatorit ekonomik ankimues. Nd r t  tjera autoriteti kontraktor informon se:

*[...] Nga data 28.02.2018. date kur njesia e prokurimit, mbas njoftimit te bere nga komisioni per perfundimin e vleresimit elektronik, i dha fazes "vleresimi i ofertave" statusin "e perfunduar", iu dha mundesia operatoreve ekonomik te interesuar qe brenda afatit ligjor te percaktuar Kreun VII, neni 63 ,pika 2 e ligjit 9643 dt.20.1 1.2006 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, te paraqesin ankesat e tyre. Ne daten 05.03.2018 ka paraqitur ankese shoqeria "Josif Deliu" sh.p.k. Me shkresen Nr 1052/1 date 06.03.2018 i eshte kerkuar kesaj shoqeria te beje korrigjimin e ankeses per arsye se nuk ishte paraqitur sipas formularit standart. Ne daten 07.03.2018, protokolluar me Nr 1128 date 07.03.2018, shoqeria "Josif Deliu" sh.p.k ka dorezuar ankesen sipas formularit standart. Mbas marrjes te ankeses eshte pezulluar procedura e prokurimit dhe me Vendim date 12.03.2018 Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave ka vendosur te pranoje ankesen e paraqitur duke dhene argumentimet si me poshte: I. Lidhur me arsyen e skualifikimit: "Nuk permbush kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit shtojca 9, Kriteria te vecanta te kualifikimit,kapaciteti teknik, Kriteria te vecanta te pranimit lidhur me kapacitetin teknik ,pika d, per arsye se: Se pari: Kontrata e qerese eshte lidhur ne emrin personal te administratorit dhe jo ne emer te shoqerise "Josif Deliu, KSHA konstatoi se: I. Ne dokumentet e tenderit shtojca 9, kriteret e vecanta te kualifikimit, II. Kriteria t  ve anta t  pranimit, lidhur me kapacitetin teknik, pika"d" eshte percaktuar si me poshte: "d-Ofertuesi te disponoje nje autobot ne pronesi ose me qera per te cilin duhet te paraqese lejen e qarkullimit te tij , Siguracionin e mjetit, Certifikaten per transport mallrash te rrezikshme brenda vendit dhe Certifikaten e kontrollit teknik te mjetit. Ne rast se eshte mare me qera te paraqese kontraten e qera-marrjes, te shoqeruar me lejen e qarkullimit te qiradhenesit, siguracionin e mjetit, Certifikaten per transport mallrash te rrezikshme brenda vendit dhe Certifikaten e kontrollit teknik te mjetit." 2. Per plotesimin e kriterit te mesiperem shoqeria "Josif Deliu" sh.p.k ka paraqitur: -Kontrate hua perdorje per mjetin autobot me targe AAXXNA te shoqeruar me Lejen e qarkullimit siguracionin e mjetit, certifikaten e kontrollit teknik te mjetit dhe nje certifikate per transport nderkombetar mallrash te rrezikshme. 3. Nga ankuesi nder te tjera pretendohet se "Kontrata e huamarrjes eshte lidhur personalisht ne emrin N.N si administrator i shoqerise "Josif Deliu" sh.p.k por nga ana juaj nuk eshte marre parasysh fakti qe N.N eshte e dhe ortak i vetem ne shoqerin e"Josif Deliu"sh.p.k e cila vertetohet me ekstraktin e QKB te paraqitur nga ana jone. Bashkelidhur me ankesen eshte paraqitur nje Vertetim nga noteri Z.B.Z me date 06.03.2018 ku konfirmohet fakti se huamarresi eshte shoqeria "Josif Deliu" sh.p.k me NIPT*



KxxxxxxL por per shkak te nje gabimi te bere gjate redaktimit te kontrates eshte shenuar si huamarres administrator i shoqerise N.N. Gjithashtu bashkelidhur me ankesen eshte paraqitur edhe nje deklarate date 06.03.2018 nga Z. K.M i cili ka firmosur kontraten e huaperdorjcs te autobotit ku deklarohet se ky mjet i eshte dhene ne huaperdorje shoqerise "Josif Deliu" sh.p.k per ta perdorur per nevoja te shoqerise. 4. KSHA verifikoi ekstraktim e regjistrit tregetar mbi te dhenat e subjektit nga ku rezultoi se Z. N.N eshte administrator dhe ortak i vetem i shoqerise "Josif Deliu" sh.p.k. 5. Bazuar ne faktin se N.N eshte administrator dhe ortak i vetem, duke patur parasysh qe behet fjale per nje lloj mjeti te vecante i cili nuk mund te perdoret per qellime te tjera vec transportit te karburanteve, gjithashtu bazuar edhe ne informacionin dhe dokumentacionin e dorezuar bashke me ankesen, KSHA arrin ne perfundimin se Kontrata e huaperdorjes e paraqitur per mjetin Autobot eshte e vlefshme per kualifikimin e shoqerise "Josif Deliu" sh.p.k. Per sa me siper pretendimi i ankesit qendron [...].

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Olsi" sh.p.k. për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik "Josif Deliu" sh.p.k., me arsyetimin se "Ky subjekt autobotin nuk e ka në emër të firmës dhe nuk pasqyrohet në bilanci. Autoboti është në emër personal të administratorit por që ky i fundit për arsye të shmangies së detyrimeve tatimore, doganore e ka në emër të tij. Ai nuk ka asnjë kontratë sikundër kërkohet në DT për të dhënë në përdorim me qira mjetin tek firma që administron. Të gjitha këto veprime duhet të vleresohen nga AK si jo në përputhje me kërkesat DT dhe oferta e tij të skualifikohet", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Loti I, në shtojcën nr. 9, pika 2.2. "Kapaciteti teknik", gërma "d", autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin:

"Ofertuesi të disponojë një autobot në pronësi ose me qera për të cilin duhet të paraqesë lejen e qarkullimit të tij, Siguracionin e mjetit, Certifikatën për transport mallrash të rrezikshme brenda vendit dhe Certifikatën e kontrollit teknik të mjetit.

Në rast se është marrë me qera të paraqesë kontratën e qera-marrjes, të shoqëruar me lejen e qarkullimit të qiradhenësit, siguracionin e mjetit, Certifikatën për transport mallrash të rrezikshme brenda vendit dhe Certifikatën e kontrollit teknik të mjetit."

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik "Josif Deliu" sh.p.k. në përmbushje të kriterit të sipërcituar, rezulton se në sistemin e prokurimeve elektronike është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

- Kontratë Huapërdorje Pasuri e Luajtshme, Nr.3893 Regj., Nr.3073 Kol., datë 06.05.2016, për mjetin “Daimler Chrysler”, me targë AA XXX NA, ndërmjet huadhënësit shoqëria “E.T.M” sh.p.k. dhe huamarrësit Z. N.N;
- Leje qarkullimi në emër të shoqërisë “E.T.M” sh.p.k., për mjetin me targë AA XXX NA;
- Certifikatë e kontrollit teknik të mjetit me targë AA XXX NA;
- Certifikatë e kryerjes së operacionit teknik të mjetit;
- Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treat, nr.110, datë 07.02.2018, për mjetin me targë AA XXX NA;
- Pasaportë nga trupa inspektuese/verifikuese Almata GmbH sh.p.k., për vendojen e botit me nr.8025 mbi automjetin me targë AA XXX NA;
- Certifikatë nr. 26, datë 03.03.2016 “Për Transport Ndërkombëtar Mallrash të Rrezikshme”, për mjetin me targa AA XXX NA, në pronësi të shoqërisë “E.T.M” sh.p.k., lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Korçë.
- Ekstraktin e regjistrimit tregëtar të lëshuar nga QKB, sipas të cilit rezulton se z. N.N. është ortak me 100 % të kuotave të shoqërisë “Josif Deliu” sh.p.k.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

III.1.4. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit”.*

III.1.5. Në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 68, përcaktohet shprehimisht se:

*“1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është një shoqëri tregtare, e themeluar nga persona fizikë ose juridikë, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.*

*2. Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital. Kapitali i regjistruar i shoqërisë ndahet ndërmjet ortakëve në kuota, sipas këtij raporti.*

*3. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara nuk mund të ofrojnë kuotat e tyre si mjete investimi për publikun e gjerë.*

*4. Me përjashtim të rasteve kur ky ligj përcakton ndryshe, marrëdhëniet ndërmjet ortakëve mund të përcaktohen në statutin e shoqërisë.*

*5. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta). Statuti përcakton mënyrat e shlyerjes së kontributeve.*

*6. Ortakët e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar i vlerësojnë kontributet në natyrë në marrëveshje të ndërsjella me njëri-tjetrin dhe i shprehin vlerat e tyre në para. Nëse nuk mund të arrihet një marrëveshje, secili prej ortakëve mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse, për të ngarkuar*

*një ekspert vlerësues, me një vendim me efekt detyrues. Raporti i ortakëve ose i ekspertit për vlerësimin e kontributeve i dorëzohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me të dhënat e tjera të kërkuara për regjistrim”.*

III.1.5. Operatori ekonomik ankimues pretendon se: *“Në kriteret e vecanta per kualifikim në piken 2.2. kapaciteti teknik pika 4: Ky subjekt autobotin nuk e ka ne emer te firmes dhe nuk pasqyrohet ne bilancet. Autoboti eshte ne emer personal te administratorit por qe ky i fundit per arsye te shmangies se detyrimeve tatimore, doganore e ka ne emer te tij. Ai nuk ka asnje kontratë sikunder kerkohet ne DT per te dhene ne përdorim me qira mjetin tek firma qe administron. Te gjitha keto veprime duhet te vleresohen nga AK si jo ne perputhje me kerkesat DT dhe oferta e tij te skualifikohet. AK me dt. 28.03.2018 ka kthyer përgjigjen per pretendimet tona, ne menyre aspak terësore dhe shume siperfaqesore madje ne shtrembërim dhe keqinterpretim te fakteve dhe argumentave te paraqitura nga ana jone.*

III.1.6. KPP sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Gjithashtu, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë fizike dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit të sipërcituar të paraqitur nga operatori ekonomik “Josif Deliu” sh.p.k. në përmbushje të kriterit kualifikues, konstaton se ky i fundit, nuk e vërteton faktin e pasjes në pronësi ose me qera të mjetit ‘autobot’, pasi ka paraqitur një kontratë huapërdorje midis huadhënësit shoqërisë “E.T.M” sh.p.k. dhe huamarrësit personit fizik z. N.N. dhe jo në emër të shoqërisë “Josif Deliu” sh.p.k., si operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi. Bazuar ekstraktit të shoqërisë “Josif Deliu” sh.p.k. të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Z. N.N., rezulton se është ortak i vetëm i kësaj shoqërie dhe administrator i shoqërisë. Referuar edhe legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se, në asnjë moment nuk përcaktohet që gjithçka në pronësi ose përdorim të ortakut si person, është edhe në pronësi të shoqërisë, në të cilën ky person është ortak, pasi janë dy subjekte të ndryshëm, që gëzojnë personalitet juridik të ndryshëm. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, referuar legjislacionit për shoqëritë tregtare janë shoqëri të themeluara nga persona fizikë ose juridikë, të cilët kanë përgjegjësi dhe përgjigjen për detyrimet e shoqërisë deri në pjesën e kapitalit të nënshkruar. Në interpretim të dispozitës së sipërcituar të legjislacionit për shoqëritë tregëtare, në rastin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, çdo pjesëmarrje tjetër

duhet bërë përmes shprehjes formale të vullnetit, pra nëpërmjet një akti ku deklarohet shprehja e vullnetit të palëve.

III.1.9. Në dokumentat e tenderit, është përcaktuar në mënyrë të qartë që operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë në pronësi një mjet ‘autobot’ ose kur nuk e kanë në pronësi mund të paraqesin një kontratë qeraje. Operatori ekonomik “Josif Deliu” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm në mënyrë që të vërtetojë se ka në pronësinë ose në përdorim në emër të shoqërisë pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi, mjetin e kërkuar në dokumentat e tenderit. Sqarojmë se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

III.1.10. Akoma më tej, nisur edhe nga informacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se autoriteti kontraktor në vlerësimin e parë (datë 28.02.2018) të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, ndër të tjera ka skualifikuar operatorin ekonomik “Josif Deliu” sh.p.k., me të njëjtin argument me atë të ngritur konkretisht nga operatori ekonomik ankimues pranë KPP, se *“kontrata e qerasë është lidhur në emrin personal të administratorit dhe jo në emër të shoqërisë “Josif Deliu”, dhe se, pas paraqitjes së ankesës nga operatori ekonomik “Josif Deliu” sh.p.k pranë autoritetit kontraktor, ky i fundit e ka pranuar ankesën e tij dhe në rivlerësimin e datës 15.03.2018 e ka kualifikuar këtë operator ekonomik me argumentin se “Bashkëlidhur me ankesën është paraqitur një Vertetim nga noteri Z.B.Z me date 06.03.2018 ku konfirmohet fakti se huamarrësi është shoqëria “Josif Deliu” sh.p.k me NIPT KxxxxxxxxL, por për shkak të një gabimi të bërë gjatë redaktimit të kontratës është shënuar si huamarrës administrator i shoqërisë z.N.N. Gjithashtu bashkëlidhur me ankesën është paraqitur edhe një deklaratë date 06.03.2018 nga Z. K.M i cili ka firmosur kontratën e huapërdorjes të autobotit ku deklarohet se ky mjet i është dhënë në huapërdorje shoqërisë “Josif Deliu” sh.p.k për ta përdorur për nevoja të shoqërisë. KSHA verifikoi ekstraktin e regjistrimit të regjistrit të dhenat e subjektit nga ku rezultoi se Z. N.N është administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë “Josif Deliu” sh.p.k. Bazuar në faktin se N.N është administrator dhe ortak i vetëm, duke patur parasysh që behet fjale për një lloj mjete të vecante i cili nuk mund të përdoret për qëllime të tjera të transportit të karburanteve, gjithashtu bazuar edhe në informacionin dhe dokumentacionin e dorëzuar bashkë me ankesën, KSHA arrin në përfundimin se Kontrata e huapërdorjes e paraqitur për mjetin Autobot është e vlefshme për kualifikimin e shoqërisë “Josif Deliu”sh.p.k.”*, pra autoriteti kontraktor ka kualifikuar operatorin ekonomik “Josif Deliu” sh.p.k. duke pranuar prej tij dokumentacion shtesë përveç dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik para hapjes së ofertave. Sa më sipër, KPP, vlerëson se, autoriteti kontraktor nuk ka qenë në kushtet e nenit 53, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. Operatori ekonomik “Josif Deliu” sh.p.k. duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave. Nuk duhet të ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Nuk mund të lejohet paraqitja e asnjë

dokumenti tjetër pas mbarimit të afatit për hapjen e ofertave, pasi një gjë e tillë do të konsiderohej ndërhyrje në ofertë.

III.1.11. Sa më sipër, nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Josif Deliu” sh.p.k., në asnjë moment nuk vërtetohet dhe nuk dokumentohet fakti se kjo shoqëri ka në pronësi apo në përdorim një mjet ‘autobot’ me qëllim përmbushjen e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, në të cilin përcaktohet se *Ofertuesi të disponojë një autobot në pronësi ose me qera për të cilin duhet të paraqesë lejen e qarkullimit të tij, Siguracionin e mjetit, Certifikatën për transport mallrash të rrezikshme brenda vendit dhe Certifikatën e kontrollit teknik të mjetit.* Autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartësisht në dokumentat e tenderit, se cilat dokumenta duhen paraqitur me qëllim vërtetimin e një fakti të tillë. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kontrata e huapërdorjes për mjetin, është në emër të një personi, dhe jo në emër të shoqërisë/operatorit ekonomik “Josif Deliu” sh.p.k. si shoqëri pjesëmarrëse në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga operatorit ekonomik “Josif Deliu” sh.p.k. në këtë procedurë prokurimi, objekt shqyrtimi, nuk është i rregullt dhe për shkak të mangësive që ka nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik “Olsi” sh.p.k. qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik “Olsi” sh.p.k. mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Josif Deliu” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, për sa kohë një nga pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues është pranuar dhe gjendja faktike e juridike e operatorit ekonomik “Josif Deliu” sh.p.k. do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, duke plotësuar kështu interesin e ligjshëm të ankimuesit, rrjedhimisht pretendimet e tjera nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Olsi” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-41452-01-22-2018, me objekt: “Blerje Karburant”, Loti 1 “Naftë”, me fond limit 30.135.061 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “Josif Deliu” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.

3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Olsi” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 668 Protokolli**

**Datë 03.04.2018**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Hektor Balluku**

**Anëtar**  
**Kleves Janku**

**Anëtar**  
**Odise Moçka**

